



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 110, Datë 21.04.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1082/1 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.05.2023 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082 prot., datë 03.04.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikim, për ndryshim në Aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 MW.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të Rregullores, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave a, d, e, f dhe g.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, “Modifikimi i Licencës”, Pika 4

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të paraqesë informacion mbi numrin e njësive të depozitimit të energjisë elektrike dhe kapacitetin e secilës.
 - **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.
- Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë të informojë mbi mënyrën e financimit të këtij investimi.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., në kushtet kur kërkesa për modifikim lidhet me shtimin e njësive të depozitimit të energjisë elektrike si vepra ndihmëse të centralit, çështje të cilat lidhen me aktet e miratuara prej tyre, aspektet mjedisore të projektit dhe operimin e centralit në raport me sistemin elektroenergjitik.”

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.05.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI